



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 24, Datë 26/02/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesit.

Mbështetur në informacionin, që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. N. D., i lindur në 15.04.1956, në Xhuxhë të Mirditës, ka përfunduar arsimin e mesëm pranë Shkollës së Mesme Industriale të Naftës, Specialiteti Shpim, në Qytetin Stalin, e në vijim ka kryer Shkollën e Partisë.

Z. N. D. ka filluar punë pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë në datën 13.09.2009, me detyrë teknik në Hidrovorin e fshatit Tale, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë. Marrëdhënia e punës, e cila është mbështetur në një kontratë individuale pune me afat të pacaktuar të lidhur midis palëve, ka zgjatur deri në datën 15.11.2018, pasi nëpërmjet shkresës nr. 561, datë 30.10.2018, punëdhënësi i ka komunikuar ankuesit zgjidhjen e marrëdhënies së punës

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

me motivacionin e mospasjes së arsimit që kërkon Neni 11, Kapitulli II-të, i Rregullores së Shfrytëzimit dhe Administrimit, të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Bujqësisë. Referuar shkresës së sipërpërmendur, sipas kësaj Rregulloreje përcaktohet detyrimisht, që punonjësi duhet të ketë arsim të mesëm të profileve mekanike, elektrike ose arsim të përgjithshëm.

Për sa më sipër, ankuesi thekson faktin se qëndrimi i padrejtë ndaj tij nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë është reflektuar edhe në Vendimin nr. 191, datë 20.03.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku janë evidentuar shkelje të këtij institucioni. Në këtë kontekst ai thekson faktin se nuk janë respektuar afatet e njoftimit dhe nuk janë zbatuar procedurat e tjera të përcaktuara në Kodin e Punës, e si rrjedhim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur detyrimin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, që të dëmshpërblejë ankuesin në shumën e 12 pagave bazë mujore për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, 3 pagave mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe 4.5 pagave mujore për vjetërsi në punë.

Njëkohësisht, ankuesi sqaron se edhe Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka konstatuar shkelje të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, për sa i përket parregullsive të konstatuara në kontratën individuale të punës të Z. N. D.. Reflektimet dhe gjetjet e këtij Inspektoriati janë reflektuar në shkresën ne. 333, datë 21.06.2019, të Degës Rajonale të ISHPSHSH-së², Qarku Lezhë, ku edhe jepen detyrat përkatëse për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.

Ankuesi N. D. pretendon për veprime tendencioze ndaj tij nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, që kanë passjellë edhe largimin e tij nga puna, duke i shkaktuar atij jo vetëm pasoja financiare, por edhe probleme serioze, shëndetësore, që evidentohen në aktet përkatëse të lëshuara nga institucionet mjekësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 110, datë 12.09.2019, e Z. N. D., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1370/1, datë 20.09.2019, Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, ku kërkohej informacion, lidhur me situatën e parashtruar nga ankuesi, ku kërkohej si më poshtë vijon:

1. Kopje e kontratës dhe librezës së punës së ankuesit;
2. Kopje e urdhërave të emërimit të ankuesit, në të gjitha pozicionet e punës, që ka mbajtur pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.
3. Praktika e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin.
4. Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore. Nëse po, të përcillen kopje të akteve përkatëse;
5. Kopje të vlerësimeve në punë të ankuesit, përgjatë viteve, që ka punuar pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.
6. Numri i përgjithshëm i punonjësve dhe specifikisht i teknikëve që janë larguar nga puna nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, me të njëjtin motivacionin si ankuesi;
7. Numri i teknikëve të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, që punojnë aktualisht pranë këtij institucioni. Kopje të plota të dosjeve të tyre të punës, ku të bëjnë pjesë: Diploma e Shkollës së Mesme, kualifikimet, karta e identitetit, CV e tyre;
8. Kopje e plotë e dosjes personale të ankuesit;
9. Kopje e strukturës organike aktuale të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, para dhe pas ristrukturimit të fundit;
10. Kopje e Rregullores së Shfrytëzimit dhe Administrimit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Bujqësisë. (*Urdhëri i Ministrit të Bujqësisë të dërgohet bashkëlidhur Rregullores*)
11. Vendimet gjyqësore, që kanë lidhje me ankuesin N. D.;

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, si dhe në mungesë të dërgimit të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, mbështetur në Urdhërin nr. 201, datë 24.10.2019, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, inspektorët e KMD-së u paraqitën për inspektim pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.

Gjatë inspektimit, në dispozicion të inspektorëve të KMD-së u vu informacioni i përgatitur nga Përgjegjësja e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Sipas informacionit

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

të administruar rezultoi se ndaj ankuesit, i cili ka qenë elektropompist pranë Hidrovorit të Tales, nuk ishte dhënë asnjë masë disiplinore, gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Për të marrë informacion më të hollësishëm mbi çështjen objekt shqyrtimi, inspektorët e KMD-së morën kontakt edhe me z.I.D., me detyrë Përgjegjës i Hidrovoreve dhe Makinerive, i cili theksoi faktin se largimi i z. N. D. motivohet vetëm me mospërputhjen e arsimit të tij me pozicionin e punës. Sipas rregullores përkatëse, për pozicionin elektropompist parashikohet kriteri i arsimit të mesëm të përgjithshëm, ose mekanik, ose elektrik. Ankuesi ka përfunduar arsimin e mesëm në Shkollën Industriale të Naftës në Qytetin Stalin, specialisteti “shpim”. Në këto kushte, kontrata individuale e punës së ankuesit është zgjidhur. Lidhur me vlerësimet në punë, z.I.D. u shpreh se praktika e vlerësimit në punë nuk ndiqet në këtë institucion, pasi marrëdhëniet e punës me punonjësit rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës. Pas analizimit të informacionit të administruar, inspektorët e KMD-së kërkuar informacion të mëtejshëm, lidhur me numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe specifikisht të elektropompistëve, të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, kontrata individuale e punës, me të cilët është zgjidhur, mbi bazën e të njëjtit motivacion, sikurse me ankuesin. Njëkohësisht, inspektorët kërkuar edhe kopje të dosjeve individuale të secilit prej tyre.

1. Në vijim të inspektimit, në përgjigje të shkresës nr. 1370/1, datë 20.09.2019, të KMD-së, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë dërgoi shkresën nr. 1370/4, datë 28.10.2019, nëpërmjet së cilës informon se bashkëlidhur dërgohen aktet e kërkuara nga Komisioneri, përkatësisht: Urdhëri i emërimit, Njoftimi i largimit nga puna, kontrata e punës, dhe vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë.

Në shkresën e sipërpërmendur, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë sqaron se z. N. D. nuk ka marrë masa disiplinore, por i është tërhequr vërejtje në mënyrë verbale për probleme të ndryshme gjatë punës.

2. Shkresa nr. 1699, datë 07.11.2019, e këtij institucioni, u dërgua në vijim pranë KMD-së. Nëpërmjet saj, përcillen pranë Komisionerit, dokumentacioni i kërkuar, lidhur me numrin e teknikëve në Hidrovoret, që mbulohen nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, të cilët janë larguar nga puna me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se edhe 4 (katër) teknikë të tjerë hidrovoresh janë larguar nga puna për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor. Bashkëlidhur janë dërguar edhe njoftimet e largimit nga puna.

Sipas informacionit të mësipërm rezulton të jenë larguar nga puna, punonjësit e mëposhtëm:

- Z. N.P., i cili është zëvendësuar me z. S.C.;
- Z. S.Q. i cili është zëvendësuar me z. A.G.;

- Z. A.Q. i cili është zëvendësuar me z. K.Gj.;
- Y.D. i cili është zëvendësuar me z. G.L.;
- Ankuesi N. D. është zëvendësuar me z. S.T. në hidrovorin Tale.

Njëkohësisht, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë ka sqaruar se numri i përgjithshëm i punonjësve të hidrovorëve është 69. Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, ky institucion ka dërguar në cilësi prove, kopje të diplomave të shkollës së mesme, si dhe kartat e identitetit të këtyre punonjësve, sipas secilit hidrovor.

3. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, ankuesi N. D. dërgoi pranë Komisionerit shkresat si më poshtë vijojnë:
 - Shkresën nr. 1739, datë 14.11.2019, ku ankuesi shton edhe pretendimin e tij për shkak të moshës, pasi për 16 muaj del në pension pleqërie, si dhe diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, të cilin e lidh me faktin se si pasojë e shqetësimeve që ka patur si pasojë e largimit nga puna, ai është shtruar në spital, si dhe ka pësuar tronditje psikike;
 - Shkresën nr. 1370/2, datë 25.09.2019, ku dërgohet bashkëlidhur përgjigja zyrtare e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe ankesa e tij drejtuar nëpërmjet e-mailit tek Task Force Anti Korrupsion;
 - Kopje të të gjitha ankesave, që ankuesi ka depozituar në institucionet e administratës publike, ku ankohet mbi largimin e tij nga puna, si dhe e-mailin drejtuar Avokates së Popullit.

D. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u realizua në datën 12.12.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesi Nikollë N. D. dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, i cili depozitoi aktin Autorizim i datës 12.12.2019, lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë së ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Z. N. D. parashtrroi edhe një herë faktet e bëra të ditura në ankesë. Ai theksoi faktin se ka filluar punë pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, në datën 13.09.2009, me detyrë teknik në Hidrovorin e fshatit Tale, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë dhe është larguar padrejtësisht nga vendi i tij i punës, për shkak të gjendjes arsimore. Ai u shpreh se ka përfunduar arsimin e mesëm pranë Shkollës së Mesme Industriale të Naftës, Specialiteti Shpim, në Qytetin Stalin, e në vijim ka kryer Shkollën e Partisë. Motivacioni i largimit nga puna ka qenë mospërputhshmëria e arsimit të tij me vendin e punës. Përveç shkakut të gjendjes arsimore, z. N. D. shtoi si shkak diskriminimi edhe bindjen e tij, politike. I pyetur se cilat ishin bindjet e tij, si dhe nëse është i anëtarësuar në ndonjë forcë politike, ai u shpreh se bindjet e tij janë të majta dhe se është i anëtarësuar pranë forcës politike Partia Socialiste e Shqipërisë. Ankuesi sqaroi se pas largimit nga puna ka paraqitur padi në gjykatë, e cila e ka pranuar padinë e tij dhe e ka

dëmshpërblyer, pasi Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, nuk e ka zbatuar procedurat përkatëse për lirim të tij nga detyra. Ndër të tjera, ankuesi u shpreh se ka edhe punonjës të tjerë që nuk plotësojnë kriterin arsimor, por ata janë mbajtur në punë, ndërkohë që kontrata e tij individuale e punës është zgjidhur. Ai theksoi faktin se është zëvendësuar nga një punonjës që ka përfunduar shkollën bujqësore, si dhe punonjësit që janë larguar, janë rikthyer të gjithë në punë.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë u shpreh se në bazë të Rregullores së Shfrytëzimit dhe Administrimit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Bujqësisë, tekniku i hidrovorit duhet të ketë arsim të mesëm mekanik, elektrik ose gjimnaz. Në këtë Rregullore nuk parashikohet që tekniku i hidrovorit të ketë arsim të mesëm pranë Shkollës së Mesme Industriale të Naftës. Fillimisht, z. N. D. u pranua të punësohej si teknik hidrovori ku punoi për disa vjet, me një shkëputje për disa kohë, e u rikthye sërish në atë detyrë. Rregullorja e miratuar nga Ministri i Bujqësisë ka qenë në fuqi edhe në periudhën kur u emërua z. N. D., por nga drejtuesi i asaj kohe u konsiderua me vend që, ai të punësohej në pozicionin e teknikut të hidrovorit. Në momentin kur, Ministri i Bujqësisë kërkoi të verifikoheshin të gjithë dosjet e teknikëve të hidrovoreve, për të evidentuar përputhjen e arsimit të tyre me atë të përcaktuar në aktin nënligjor të përmendur më sipër, rezultoi se z. N. D., sikurse edhe disa punonjës të tjerë nuk plotësonin kriterin arsimor. Në këto kushte, për të gjithë këta punonjës u zgjidh kontrata individuale e punës. Ai sqaroi se Rregullorja e Hidrovoreve është e miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë duhet të zbatojë përcaktimet e këtij akti. Lidhur me pretendimin e ankuesit se, ai është zëvendësuar nga një punonjës tjetër, që ka përfunduar arsimin bujqësor, përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë u shpreh për punësimin e këtij punonjësi, ky institucion ka marrë paraprakisht konfirmimin e Drejtorisë Arsimore Lezhë, e cila ka konfirmuar se shkolla bujqësore konsiderohet njëlloj si gjimnazi.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë u shpreh se dosjet e të gjithë personelit janë analizuar e shqyrtuar nga Drejtori i këtij institucioni. Në vijim, doli lista e punonjësve që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara nga Rregullorja. Punonjësit e rikthyer në punë kanë sjellë në vijim dokumentin përkatës arsimor sipas parashikimit të Rregullores.

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ rezulton se ankuesi ka përfunduar arsimin e mesëm pranë Shkollës së Mesme Industriale të Naftës, Specialiteti Shpim, në Qytetin Stalin⁴, e në vijim ka kryer Shkollën e Partisë. Referuar librezës së punës së ankuesit rezulton se ai është teknik shpimi i shkollës së dytë të kualifikimit. Përgjatë periudhës shtator 1977 deri në janar 1980, z. N. D. ka punuar fillimisht stazhist e në vijim teknik shpimi pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Kukës. Në vijim, përgjatë periudhës 15.03.1982 - 10.09.1989, ka punuar teknik shpimi pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Rubik. Nga data 01.09.1989 – 15.03.1991 ka ndjekur Shkollën e Partisë, e më pas është rikthyer pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Rubik, ku ka punuar deri në 31.07.1992. Më pas në librezë rezulton shënimi “*Del në përkrahje sociale*”. Asistenca sociale për z. Nikollë N. D. ka përfunduar në datën 31.08.1993. Në vijim eksperiencia e punës së ankuesit është në miniera, deri në momentin kur, nëpërmjet Urdhërit nr. 34/1, datë 13.11.2009, të Drejtorit Ekzekutiv të Bordit të Kullimit Lezhë, z. Nikollë N. D. është emëruar në pozicionin e teknikut në Hidrovorin e Tales Lezhë. Në Urdhërin e sipërpërmendur citohet: “*1. Të fillojë punë z. Nikollë N. D. në hidrovorin Tale me arsim të mesëm me profesion elektropompist në vend të z. Lek Jaku i cili shkëputet nga puna për arsye shëndetësore dhe i paaftë fizikisht në ushtrimin e profesionit.*” Marrëdhënia e punës është mbështetur në një kontratë individuale punë me afat të pacaktuar të lidhur midis palëve.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton mospërputhje të arsimit të ankuesit, që në referencë të Dëftesës së Pjekurisë është “*teknik shpimi*”, me Urdhërin e emërimit nr. 34/1, datë 13.11.2009, të Drejtorit Ekzekutiv të Bordit të Kullimit Lezhë, ku është shënuar “*me arsim të mesëm me profesion elektropompist*”.

Në referencë të nenit 11, të Rregullores së Shfrytëzimit dhe Administrimit të Stacioneve të Pompave Aksiale, Hidrovoret, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, në vitin 1998, parashikohet shprehimisht: “*Punëtorët e çdo ndërrese do të jenë: a. përgjegjësi i ndërresës me kategorinë e V-të si elektropompist; b. ndihmësi me kategorinë e IV-të; Në raste të mosplotësimit të kushtit të mësipërm të pranohen elektrikist dhe mekanik përkatësisht me kategorinë IV-të, por brenda një viti të mbrojnë kategorinë e V-të si elektropompist dhe të njohë shumë mirë grupin e III-të të teknikës së sigurimit. Deri në aftësimin e tyre si elektropompistë, ata të punojnë si ndihmësa. Elektropompistët të jenë më arsim të mesëm elektrik, mekanik ose të përgjithshëm.*”

⁴ Referuar aktit Dëftesë Pjekurie me Nr. amze - 610, datë 30.06.1977, nga Drejtori i Shkollës së Mesme Industriale të Naftës, Specialiteti Shpim, në Qytetin Stalin;

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se z. Nikollë N. D. është emëruar në vitin 2009, në pozicionin e elektropompistit, pa patur arsimin e mesëm elektrik, mekanik ose të përgjithshëm, të përcaktuara në Rregulloren e Shfrytëzimit dhe Administrimit të Stacioneve të Pompa Aksiale, Hidrovoret, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, në vitin 1998. Në urdhërin e tij, të emërimit në detyrë është shënuar se ankuesi ka arsim të mesëm dhe me profesion elektropompist, ndërkohë që referuar akteve të depozituara pranë KMD-së, ai rezulton se është teknik shpimi naftë.

Pavarësisht sa më sipër, z. N. D. ka punuar në pozicionin e elektropompistit pranë Hidrovorit në Tale, Lezhë, deri në datën 15.11.2018. Nëpërmjet shkresës nr. 561 prot., datë 30.10.2018, të Drejtorit të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, ai njoftohet si vijon: *“Referuar dokumentacionit që Ju keni depozituar në zyrën e administratës nuk plotësoni kushtin e arsimit që kërkon rregullorja e shfrytëzimit dhe administrimit neni 11, kapitulli i dytë, miratuar me urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë. Në këtë rregullore përcaktohet detyrimisht që punonjësit duhet të kenë arsimin e mesëm të profileve mekanike, elektrike ose të përgjithshëm (gjimnaz). Për këtë ju bëjmë me dije se me datë 15.11.2018, ndërpriten marrëdhëniet financiare”*. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë e ka bërë me dije Komisionerin se përveç z. N. D., janë larguar edhe 4 punonjës të tjerë, që nuk kanë përmbushur kriterin arsimor, përkatësisht: Z. N.P., i cili është zëvendësuar me z. S.C.; Z. S.Q. i cili është zëvendësuar me z. A.G.; Z. A.Q. i cili është zëvendësuar me z. K.Gj.; Y.D. i cili është zëvendësuar me z. G.L.;

Ankuesi e ka kundërshtuar gjyqësisht zgjidhjen e kontratës së tij të punës, për efekt të mozbatimit të rregullt të procedurave për zgjidhjen e saj, në mbështetje të Kodit të Punës. Me Vendimin nr 191, datë 20.03.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë, që konsiston si vijon: *“Detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier që të dëmshpërblejë paditësin Nikollë Mark N. D. me shumën e 12 pagave bazë mujore për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëherëshme dhe të pajustificuar; Detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier që të dëmshpërblejë paditësin Nikollë Mark N. D. me shumën e 3 pagave bazë mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhje të kontratës së punës; Detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, që të dëmshpërblejë paditësin Nikollë Mark N. D. me shumën e 4.5 pagave bazë mujore për vjetërsi në punë.”* Vendimi i sipërpërmendur është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit.

Referuar akteve të depozituara nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë rezulton se z. Nikollë N. D. është zëvendësuar nga z. S.T., i cili ka arsim të mesëm, të përgjithshëm. Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi provë pranë KMD-së, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe

Kullimit Lezhë, rezulton se në Hidrovorin e Tales punojnë 9 elektropompistë, nga të cilët pothuajse gjysma e tyre kanë arsim të mesëm bujqësor. Megjithëse arsimi i mesëm bujqësor nuk parashikohet si kriter punësimi për elektropompistët, ata teknikë me këtë arsim janë mbajtur në punë pranë Hidrovorit të Tales. Lidhur me këtë fakt, përfaqësuesi i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë u shpreh se ky institucion kishte marrë paraprakisht konfirmimin e Drejtorisë Arsimore Lezhë, për mbajtjen në punë të punonjësve që kishin arsim në këtë degë. Sipas këtij konfirmimi të ish-DAR Lezhë, shkolla e mesme bujqësore njehsohet me gjimnazin. Në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë nuk depozitoi asnjë akt që të vërtetonte sa më sipër. Njëkohësisht nga shqyrtimi i dokumentacionit të elektropompistëve në hidrovore të tjera, në varësi të Drejtorisë së Ujitjes e Kullimit, rezultonin të punësuar edhe elektropompistë të tjerë, që kishin arsim të mesëm bujqësor, industrial ose shkollën e mesme të ndërtimit.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Shfrytëzimit dhe Administrimit të Stacioneve të Pompa Aksiale, Hidrovoret, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, në vitin 1998, nuk janë zbatuar njësoj për të gjithë teknikët e hidrovoreve, pranë Drejtorisë së Ujitjes e Kullimit Lezhë. Pavarësisht faktit se, z. N. D. nuk ka arsimin e përcaktuar në Rregulloren e Shfrytëzimit dhe Administrimit të Stacioneve të Pompave Aksiale, Hidrovoreve, ai ka punuar për një periudhë të gjatë si elektropompist në Hidrovorin Tale, Lezhë, përkatësisht nga data 13.11.2009, deri në datën 15.11.2018. Përgjatë kësaj periudhe 9 vjeçare pranë Hidrovorit të Tales, ai ka fituar eksperiencë të mjaftueshme pune për të qenë elektropompist, ka kryer një punë të mirë dhe ndaj tij nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Komisioneri vlerëson se eksperiencia e punës e fituar në një pozicion pune është tepër e rëndësishme. Ankuesi ka një profil arsimor, i cili ka afërsi me profilet e përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Ministri i Bujqësisë.

Në këtë kontekst, në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme se z. Nikollë N. D. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.

B. Shkaku i mbrojtur

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, “*bindjes politike*”, “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*moshës*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Tre shkaqet e fundit janë shtuar nga ankuesi përgjatë shqyrtimit administrativ të ankesës.

1. “*Gjendja arsimore*”, “*bindja politike*”, “*gjendja shëndetësore*” dhe “*mosha*” janë shkaqe, për të cilat, ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e mësipërme, Komisioneri gjykon se këto konsiderohen si një shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

C/1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen arsimore”.

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

Diskriminimi në vetëvete karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk e posedon karakteristikën e mbrojtur.

Gjatë procesit të hetimit rezultoi gjithashtu se edhe 4 (katër) punonjës/teknikë të tjerë, që punonin në hidrovoret e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, që nuk kanë arsimin e përcaktuar në Rregulloren për Hidrovoret, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, në vitin 1998, u është zgjidhur kontrata e punës, sikurse ankuesit.

Ndërkohë që, vlen të theksohet fakti se, disa punonjës/teknikë të tjerë në Hidrovoret që mbulohen nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, edhe pse nuk kanë arsimin e përcaktuar në Rregulloren për Hidrovoret, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, në vitin 1998, punojnë ende në vendet e tyre të punës. Këta punonjës rezultojnë se kanë arsim të mesëm bujqësor, industrial, etj., por pavarësisht këtij fakti, atyre nuk u është zgjidhur kontrata e punës nga punëdhënësi, sikurse është bërë me ankuesin. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se gjendja arsimore nuk mund të jetë shkak për trajtimin e pabarabartë, ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar nga Drejtoria e Ujitjes e Kullimit Lezhë.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Në mungesë të një lidhjeje shkakësore, ndërmjet këtyre dy elementëve thelbësorë, që përcaktojnë diskriminimin e ndodhur, Komisioneri gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

C/2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen shëndetësore”.

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese Komisioneri konstatoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, presupozohet se në cilësinë e shkakut të mbrojtur të diskriminimit, gjendja shëndetësore në vetëvete, duhet të përbëjë arsyen reale për largimin nga puna të z. N. D..

Për sa më sipër, ankuesi shprehet se shëndeti i tij ka patur probleme, si pasojë e largimit nga puna, që do të thotë se në vetëvete gjendja shëndetësore nuk ka qenë shkak për largimin e tij nga

puna. Ankuesi ka depozituar akte e foto, që vërtetojnë faktin e shtrimit të tij në spital, por një gjë e tillë, rezulton se ka ndodhur pas zgjidhjes së kontratës së punës së lidhur me Drejtorinë e Ujitjes e Kullimit Lezhë.

Në këtë kontekst, rezulton se gjendja shëndetësore nuk mund të jetë shkak për trajtimin e pabarabartë, ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar nga Drejtoria e Ujitjes e Kullimit Lezhë, prandaj Komisioneri gjykon se në rastin konkret, gjendja shëndetësore nuk përbën shkak diskriminimi, por mund të jetë pasojë e tronditjes së ankuesit pas zgjidhjes së kontratës së punës.

C/3. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “bindjen politike”.

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese Komisioneri konstatoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, presupozohet se bindja politike e z. N. D. përbën shkak për largimin e tij nga puna.

Referuar aktit Kartë Anëtarësie nr. 128423, të lëshuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila është depozituar nga ankuesi në cilësi prove, vërtetohet fakti se ai është pjesë e forcës politike aktualisht në pushtet. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila aktualisht drejtohet nga një përfaqësues i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Drejtuesi i mëparshëm i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, z. N. P., i cili ka qenë titullar i këtij institucioni në periudhën, kur ankuesi është larguar nga puna, është gjithashtu përfaqësues i këtij subjekti politik. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se është e pamundur që z. N. D. të jetë larguar nga puna për shkak të bindjeve të tij politike, të cilat janë të njëjta me ato të drejtuesve të këtij institucioni.

Në seancë dëgjimore, z. N. D. u shpreh se ai ka punuar pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, gjatë periudhës kohore kur këtë institucion e ka drejtuar një përfaqësues e anëtar i forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim. Kjo sipas tij, në vijim kjo mund të ketë qenë penalizuese për zgjidhjen e kontratës së tij të punës.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk ka provuar me fakte dhe prova konkrete faktin e mësipërm dhe e përjashton si shkak diskriminimi bindjen politike të ankuesit.

C/3. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “moshën”.

Në ankesën nr. 110, datë 12.09.2019, e z. N. D., pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Gjatë shqyrtimit të kësaj anese Komisioneri konstatoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Në këtë kontekst, presupozohet se mosha e z. N. D. përbën shkak për largimin nga puna. Ankuesi është i datëlindjes 10.04.1956 dhe mosha e tij është pothuajse 64 vjeç.

Nëse do t'i referohemi akteve të depozituara në cilësi prove nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, rezulton se ka edhe teknikë të tjerë, që punojnë në hidrovoret në varësi të këtij institucioni, që kanë moshë të njëjtë ose edhe më të madhe se ankuesi. Në këtë kontekst, përmendim faktin se pranë Hidrovorit Tale, z. P.K. është i datëlindjes 10.11.1955 dhe punon ende si teknik pranë këtij hidrovori.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se mosha nuk përbën shkak diskriminimi të ankuesit Nikollë N. D..

Nga analizimi i fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ të ankesës së z. Nikollë N. D., rezultoi se pavarësisht se ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, ndërmjet këtij trajtimi dhe shkaqeve të diskriminimit të pretenduara nga ankuesi nuk ekziston një lidhje shkakësore e mbështetur në prova konkrete.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 e 13, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të z. Nikollë N. D., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak – gjendja arsimore, bindja politike, gjendja shendetesore.